

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-ës
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-122/2014

Prishtinë, 1 qershor 2016

Në çështjen juridike të:

Subjekti juridik **U.K. DOO**

Oraska 45

Rruga 11320 Velika Plana

Republika e Serbisë

Pala ankuese

Përfaqësues: A.Q.V. , avokat

Prishtinë

Kundër

N.H.

Dardania Su 4/7 D-1 7

Prishtinë

Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga Beshir Islami, si kryetar i kolegjit, Rolandus Bruin dhe Anna Bednarek, gjyqtarë, duke vendosur lidhur ankesën e paraqitur kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës (tani e tutje KKPK) nr. KPCC/D/A/216/2013 (lënda e regjistruar në AKP me numrin KPA14330), të datës 21 gusht 2013, pas shqyrtimit të mbajtur më 1 qershor 2016 mori këtë:

AKTGJYKIM

Ankesa e paraqitur nga U.K. DOO kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës nr. KPCC/D/C/216/2013, të datës 21 gusht 2013, sa i përket kërkesës me numër KPA14330, hedhet poshtë si e paafatshme.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

1. Më 10 tetor 2006, M.R. si përfaqësues i autorizuar i subjektit juridik U.K. DOO (tani e tutje: pala ankuese) ka paraqitur kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronave(AKP), me të cilën ka kërkuar vërtetimin e së drejtës pronësore, ri-posedim dhe kompensim për shfrytëzimin e kundërligjshëm të objekteve afariste (objektet ndihmëse dhe të tjera) të cilat gjenden në zonën ushtarake/depot e karburanteve në Han të Elezit (më parë i njohur si: Gjeneral Jankovic), në pikë kalimin kufitar në Kaçanik, me sipërfaqe prej 200 m² (tani e tutje: prona e kërkuar).
2. Kërkesa është njoftuar më 4 mars 2009, duke vendosur njoftimin në pronën e kërkuar. Gjate njoftimit është gjetur se prona e kërkuar ishte objekte afariste të zëna nga K.P. . Në atë kohë, K.P. nuk kishte kërkuar të drejta juridike mbi pronën.
3. N.H. ka dërguar përgjigje ndaj kërkesave. Ai pretendon se K.P. është bartës i së drejtës pronësore të pronës së kërkuar.
4. Me vendimin e tij të 21 gushtit 2013 (nr. KPCC/D/C/216/2013), KKPK ka vendosur ta hedhë poshtë kërkesën me arsyetimin se kërkesa ka të bëjë me pronë të luajtshme e jo me pronë private të paluajtshme dhe si e tillë bie jashtë juridiksionit të KKPK-së. Lidhur me kërkesat e palës ankuese për kompensim, KKPK-ja ka sqaruar se kjo kërkesë mund t'i adresohet gjykatave kompetente vendore. Në faqen e fundit, vendimi i KKPK-së përmban informacione lidhur me mundësinë e paraqitjes së ankesës brenda 30 ditësh nga data e njoftimit të vendimit.
5. Më 20 dhjetor 2013, vendimi i KKPK-së mbi kërkesën i është dorëzuar palës ankuese.

6. Më 18 dhjetor 2013, AKP-ja ia ka dorëzuar N.H.t vendimet e KKPK-së. Ai ka refuzuar që ta pranojë vendimin duke theksuar se ai vetëm ka vepruar si përfaqësues i bartësit të së drejtës pronësore.
7. Më 31 janar 2014, pala ankuese ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKPK-së pranë Gjykatës Supreme të Kosovës.

Pretendimet e palëve

8. Pala ankuese thekson se vendimi i kundërshtuar përmban gabime themelore në vlerësimin e kërkesës për shkak të vërtetimit të gabuar të fakteve të cilat kanë çuar në zbatim të gabuar të ligjit material. Prandaj, pala ankuese kërkon nga Gjykata Supreme që ta anulojë vendimin a apeluar dhe ta pranojë si të bazuar kërkesën e paraqitur pranë AKP-së.

Arsyetimi ligjor

Pranueshmëria e ankesës

9. Ankesa është e paafatshme.
10. Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 mbi zgjidhjen e kërkesave lidhur me pronën e paluajtshme private, duke përfshirë pronën bujqësore dhe atë komerciale, siç është ndryshuar me Ligjin nr.03/L-079 (tani e tutje: Rregullorja e UNMIK-ut 2006/50) përcakton si në vijim: *“Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë në Gjykatën Supreme të Kosovës përmes Sekretarisë ekzekutive të Agjencisë Kosovare të Pronës”*.
11. Vendimi i KKPK-së i është dorëzuar palës ankuese të premtën më 20 dhjetor 2013. Pra, afati kohor prej 30 ditësh ka përfunduar të dielën më 19 janar 2014, por është vazhduar deri të hënën më 20 janar 2014 në përputhje me nenin 7.2 të Udhëzimit Administrativ nr. 2007/5 mbi implementimin e Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, siç është ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 në aneksin 1 të atij ligji.

12. Megjithatë, pala ankuese ka paraqitur ankesë më 30 janar 2014. Ai është udhëzuar mjaftueshëm lidhur me afatin pasi që vendimi përmbante udhezimin lidhur me këtë afat.
13. Ai nuk ka paraqitur asnjë arsye të vlefshme për këtë vonesë. Kjo do të thotë se ai ka paraqitur ankesë jashtë afatit kohor prej 30 ditësh.
14. Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë për arsye procedurale si e paafatshme në pajtim me nenin 13.3 nën-paragrafin (b) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50.

Këshillë juridike

15. Në pajtim me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, ky aktgjykim është i formës së prerë dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme apo të jashtëzakonshme juridike.

Beshir Islami, Kryetar i kolegjit

Anna Bednarek, Gjyqtare EULEX-it

Rolandus Bruin, Gjyqtar i EULEX-it

Sandra Gudaityte, Referente e EULEX-it